



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:217323
Datë: 21.12.2021
Numri i dokumentit: 02533922

AA.nr.1010/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit Mehmet Ndrecaj dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.H. shpk, me seli në Gracanicë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në Prishtinë, me bazë juridike vlerësim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.2247/2021, të datës 29.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.12.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit B.H. shpk, e datës 15.11.2021, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.2247/21, i datës 29.10.2021, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin e ankimuar me ankesë e ka hedhë poshtë padinë me numër A.nr.2247/21 e datës 27.09.2021, e paditësit B.H. shpk, me seli në Gracanicë, si e paraqitur pas kalimit të afatit ligjor. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit B.H. shpk, e parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.2247/21. Të anulohet në tërësi Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -

Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.2247/21, i datës 29.10.2021, dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje sipas padisë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1, të Ligjit për konflikte administrative, (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ligj i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA , gjeti se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi me datë 27.09.2021 kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, lidhur me vendimit nr.prot.... i dt.....

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të parashtruar me datë 27.09.2021, si datë e dorëzimit në postë, dhe shkresave tjera të lëndës, ka bërë përlllogaritjen e ditëve kalendarike, dhe ka konstatuar se nuk mund të veprohet sipas kërkesëpadisë së parashtruar me padi, pasi që padia e paditësit “B.H.” Sh.P.K, me seli në Graçanicë, është e ushtruar pas kalimit të afatit ligjor, sepse këtu paditësi me datë 25.08.2021, e ka pranuar vendimin kontestues ... të datës 16.08.2021, sipas dëshmisë - flet kthesës së pranimit të vendimit ..., e të deponuar në Gjykatë nga e paditura me përgjigje në padi, e ndaj të cilit vendim këtu paditësi ka pasur të drejtë padie pranë kësaj gjykatë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit dhe si ditë e fundit e paraqitjes së padisë në Gjykatë ka qenë data 24.09.2021, e premte, mirëpo këtu paditësi nuk e ka respektuar këtë afat ligjor ndërsa padinë e ka ushtruar jashtë afati dhe atë me datë 27.09.2021, si datë e dorëzimit në postë, andaj bazuar në të gjitha këto si më lartë kjo Gjykatë nxjerr aktvendim për hedhjen poshtë të paditës së paditësit, në kuptim të nenit 34 par.1 pika 1.1, të LKA-së

Në nenin 34 par.1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative është parashikuar shprehimisht se “*Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme*”.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke e shqyrtuar aktvendimin e shkallës së parë, në bazë të ankesës dhe sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe nenit 194 të LPK-së të njëjtin në tërësi e konfirmon si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj, sepse paditësi nuk ka ushtruar padi brenda afatit ligjore kundër vendimit I njëjti vendimin kontestues ... të datës 16.08.2021, sipas flet kthesës të pranimit të vendimit ..., e ka pranuar me datë 25.08.2021 ndërsa padinë, e ka dorëzuar përmes postës me datë 27.09.2021 pra jashtë afatit të paraparë ligjor. Paditësi ka lëshuar afatin për fillimin e procedurës gjyqësore në konflikt administrativ ashtu si parashihet me nenin 27 të LKA, padia ka mundur të paraqitet në afatin prej 30 ditë nga dita e pranimit të aktit përfundimtar në procedurë administrative.

Në raport me pretendimet e paditësit në ankesë se, gjykata ka bërë shkelje me rastin e vendosjes së çështjes sipas padisë së paditësit, sepse gjykata është dashur ti referohet datës kur padia është dorëzuar në postë, respektivisht datës që gjendet në fletë dërgesën e postës 24.09.2021 dhe jo vulës që ka padia në faqen e parë të saj pasi që kjo vulë është vendosur pasi që padia ka mbërritur në gjykatë. Kolegji i apelit këtë pretendim e refuzoj si të pabazuar. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me konstatim të gabuar të gjendjes faktike

siç pretendon paditësi në ankesë, për faktin se gjykata e shkallës së parë i është referuar datës së dorëzimit të padisë në postë datës 27.09.2021, e jo datës së pranimit në gjykatë siç pretendon paditësi në ankesë. Në bazë të vulës së gjykatës padia në gjykatë është pranuar me datë 28.09.2021.

Kolegji vërtetoi faktin se paditësi vendimin e të paditurës ... të datës 16.08.2021, e ka pranuar me datë 25.08.2021 ndërsa padinë e ka dorëzuar përmes postës me datë 27.09.2021, pra jashtë afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh. Andaj me të drejt Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuptim të nenit 34 par.1 pika 1.1 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji vlerëson, se në këtë çështje juridike administrative në procedurë gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë drejtë është vendosur çështja dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, andaj janë të pa ndikim Pretendimet ankimore për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative juridike.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 209 par, b) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.1010/2021, me datë 07.12.2021

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi